



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 813/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Suzan Kika, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Suzan Kika, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.813/2017 e datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017, ka pranuar një apel nga Suzan Kika, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, i cili pretendon se ka mospërputhje të rezultateve nga raportet e KQZ me rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ me të cilën i mungojnë votat. Parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimin me numër 1911E/02R iu kanë shënuar 3 vota, në vendvotimin 1911E/02R o vota dhe pretendon se është dëmtuar për 3 vota në vv. 1915E/05R pretendon se subjekti politik në kuti i ka 39 vota kurse nuk është e kjashtë nga sa vota i kanë kandidatët na kjo parti gjegjësisht nga subjekti politik AAK. Kërkon nag paneli të rinumërohen votat në këto vendvotime: 1917E/01R,05R,06R dhe 07D në shkollën fillore Gjergj Fishta, në vv.1922E/01R,04R,05R,06R,07R, dhe 09D në shkollën fillore “Emin Duraku”, në VV 1925 E/01R,02R në VV 1925E/01R,02R,03R dhe 04R në shkollën fillore Meto Bajraktari. Po ashtu kërkon nga PZAP-i të bëhet përmisimi i gabimeve të numërimit të votave të sakta dhe të cilat nuk janë përshkruar në mënyrë të drejtë në procesverbale dhe në publikimin e rezultateve nga ana e KQZ-së.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ne apel të apeluesit janë të pabazuara pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse lidhur me pretendimet e parashtruara në apel.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apeluesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.813/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*